

**KOMUNA E DEÇANIT**

MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI

Drejtoria për
Administratë

03 Nr. _____ 2020

Dt. . 13 / 01 / 2020

PLANI VJETOR I PUNËS

Duke u bazuar në kërkesën e Kryetarit të Komunës dhe përgjegjësit e deleguara menaxhuese të Drejtorisë për Administratë në Deçan dhe duke respektuar ligjet bazike në fuqi si :

- Ligji i Vetëqeverisjes Lokale Nr. 03/L-040
 - Ligji i Gjendjes Civile Nr. 04/L-003
 - Statutin e Komunës së Deçanit :
- Hartojmë Planin Vjetor të Punës për vitin 2020

Drejtoria për Administratë organizohet përmes **Sektorëve** dhe **Zyrave** të ndryshme :

- Zyra Ligjore
- Sektorin e Gjendjes Civile
- Sektori i Qendrës për Shërbim me Qytetar / QSHQ - ja
- Sektorin për Mirëmbajtjen dhe Sigurinë të Objekteve Komunale
- Zyra për Punë të Kuvendit
- Zyrën për Teknologji Informativ / IT
- Zyrën për Furnizim dhe
- Zyra për Përkthime

➤ **Sektori i Gjendjes Civile**

Organizohet përmes Zyrave të Vendit : Deçan , Irzniq , Dranoc dhe Strellc , gjithashtu ky Sektor e ka edhe Zyrën Ligjore dhe Zyrën Pritëse / QSHQ – Qendra e Shërbim për Qytetarë . Gjithë angazhimi i këtij Sektori bazohet në Ligjin e Gjendjes Civile Nr. 04/L-003 .

punëve ditore , kemi bërë përpjekje që në Planin e Punës Shërbimi të funksionojë pandërprerë gjatë gjithë vitit .

Për t'i arritur këto qëllime kemi planifikuar buxhet të mjaftueshëm nga kategoria Mallra dhe Shërbime për gjithë vitin. Gjithashtu në koordinim me stafin e shërbimit jemi dakorduar që në muajt e fluksit të bashkatdhetarëve që vijnë për pushime vjetore të racionalizohen kërkesat e pushimeve vjetore në atë mënyrë që shërbime të mos mbetet pa staf shërbyes .Të njëjtat dakordime janë bërë edhe me Zyrën Ligjore dhe Zyrën Pritëse – QSHQ – në .

Në synimet strategjike të Sektorit të Gjendjes Civile synojmë që objektin e Gjendjes Civile në fshatin Irzniq ta merremetojmë përmes investimeve me efikasitet në mënyrë që zyrtarin e kësaj zyre ta dërgojmë me shërbim afër qytetarëve.

Gjithashtu planifikojmë që brenda mundësive të rregullojmë një zyre solemne për kurora.

Zyra për Punë të Kuvendit

Kujdeset për përgatitjen e materialeve për përmbushjen e kërkesave nga Plani i Punës së Kuvendit dhe Ekzekutivit Komunal , si dhe ruajtjen e të gjitha akteve normative të Komunës si :

- Statutin e Komunës së Deçanit
- Rregulloret Komunale
- Vendimet e Ekzekutivit , Kuvendit Komunal dhe Komitetit për Politikë dhe Financa / KPF-së / .

Po ashtu Zyra për Punë të Kuvendit në bashkëpunim me Kryesuesin e Kuvendit dhe Kryetarin e Komunës përpilojnë rendin e punës për çdo seancë të kuvendit , seancat e KPF – së , seanca të jashtëzakonshme si dhe seancat me publikun , gjithashtu nga të gjitha këto takime mbanë procesverbale .

Kjo Zyre njofton MAPL – në për të gjitha këto takime , sipas Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale .

➤ Sektorin për Mirëmbajtjen dhe Sigurinë të Objekteve Komunale

Në këtë Sektor shumica e angazhimeve kryhen përmes kompanive të kontraktuara nga komuna . Gjithashtu pjesë e këtij sektori janë edhe shërbyesit e rojeve dhe parkingut

te Komunes . Ene ne kete sektor jemi angazhuar qe te mbes mangoj sherbime eane kal shërbyesit kanë të drejtën e pushimit vjetor .

Hapësira të veçanta për parking do të kenë :

- Veturat zyrtare
- Veturat e shërbyesve civil
- Veturat e shoqatave dhe mekanizmave tjerë që veprojnë në Pallatin e Kulturës
- Ndërsa pjesa tjetër e platesë-parkingut do të dedikohet për pritje të mysafirëve dhe delegacioneve të ndryshme .

Të gjithë shërbyesit civil që shfrytëzojnë parkingun e komunës do të pajisën me kartela identifikuese .

➤ Zyra për Teknologji Informative / Zyra e IT – së

- ✚ Zyra / Menaxheri për Teknologji Informative / IT – ja , menaxhon Teknologjinë Informative të Komunës e që ka të bëjë me zhvillimin , mirëmbajtjen e Teknologjisë Informative të e - Qeverisjes / Qeverisjes elektronike / si dhe ndihmon zyrtarët e Komunës në përdorimin e komunikimit elektronik .
- ✚ Ndhmon të Implementohen Proceset Administrative / Aplikacionet e Internetit , Intranetit , e - Arkiva , smaed – aplikacioni , e - Pasuria , Aplikacionit të Gjendjes Civile , Ueb - Faqes zyrtare të Komunës , etj. / dhe të avancohen shërbimet e Qeverisjes Elektronike / e - Qeverisjes / për zyrtarët e Komunës
- ✚ Menaxhon llogaritë aktuale , si dhe krijon llogari të reja për zyrtarët e Komunës
- ✚ Mirëmban rrjetin e Internetit / Intranetit brenda objektit të Komunës
- ✚ Mirëmban Softuerët Operativ dhe Aplikativ aktual të licencuar si dhe Instalon Softuerët me përformanca të avancuara në kompjuterët e zyrtarëve të Komunës
- ✚ Mirëmban dhe rifreskon Ueb - Faqen zyrtare të Komunës
- ✚ Bashkëpunon me zyrtarin për Informim dhe zyrtarët tjerë të Komunës në lidhje me publikimet në Ueb - Faqen zyrtare të Komunës
- ✚ Jap ndihmë profesionale zyrtarëve të Komunës në lëmin e Teknologjisë Informative / IT – së
- ✚ Kujdeset për funksionimin e Pajisjeve për Teknologji Informative / TI – së , brenda objektit të Komunës

- ✚ Kryen edhe punë tjera në lëmin e Teknologjisë Informative dhe Komunikimit / TIK – ut brenda objektit të Komunës

Synimet e Zyrës për Teknologji Informative / IT – së janë :

- ✚ Realizimi i Projekteve për Instalim komplet të rrjetit të Intranetit / LAN në katin përdhese të objektit të komunës si dhe furnizimi me Pajisje të TI – së për këtë Projekt .
- ✚ Digjitalizimi komplet i Sallës së Kuvendit
- ✚ Avancimi / ngritja e nivelit të performancave të Pajisjeve të IT – së
- ✚ Pajisja e dhomës së Serverëve me Invertor dhe APC/UPS-sa
- ✚ Etj.

➤ Zyra e Furnizimit

Funksionon mbi bazën e kërkesave nga zyra e Kryetarit si dhe kërkesave të Drejtorive veç e veç , e gjithë kjo duke u bazuar në kontratat që kryhen nga Zyra e Prokurimit .

Për të gjitha angazhimet e stafit të Drejtorisë për Administratë si dhe synimet e kësaj Drejtorie Kryetari i Komunës do të informohet përmes raporteve periodike . Gjithashtu do ti kushtohet kujdes racionalizmi të shpenzimeve të kategoria mallra dhe shërbime .

Në realizimin e këtij plani dhe synimeve tona për përmirësimin e gjendjes së tanishme dhe ofrimin e mundësive të reja për shërbime të qytetarëve , natyrshëm kërkojmë përkrahjen e ekzekutivit komunal .

Angazhohemi dhe synojmë realizimin e të gjitha obligime që dalin nga përgjegjësitë tona .

Sinqerisht :

Drejtori i Drejtorisë për Administratë

Jashar DOBRAJ
